



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrimit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 52/2021

Datë: 29.09.2021

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z.Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), në bazë të nenit 58 të Ligjit Nr.02/L – 59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 1 (8) të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30 mars 2021), si dhe në Vendimin Nr.08-V053 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për themelimin e institucionit të Operës së Kosovës si institucion i shërbimit publik pas propozimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përkatësisht Qeverisë së Republikës së Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Meriton Ferizi, bashkëpunëtor profesional në institucionin e Filharmonisë së Kosovës, emërohet Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Operës së Kosovës.
2. I emëruari si në pikën një (1) të këtij Vendimi detyrën e tij e ushtron deri në momentin që krijohen kushtet adekuate për funksionalizimin të institucionit të Operës së Kosovës.
3. Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Operës ushtron të gjitha të drejtat dhe obligimet e përcaktuara për pozitën e Drejtorit të institucionit të Operës, sikurse përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.02/L – 59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin, veçanërisht është përgjegjës për të inicuar, zhvilluar dhe administruar të gjitha procedurat për krijimin e strukturës bazike të të punësuarve në institucionin e Operës në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit apo organet e emëruara prej saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Operës së Kosovës ka pagën mujore ekuivalente me pozitën e drejtorit të Filharmonisë së Kosovës dhe Baletit Kombëtar të Kosovës.
5. Obligohet Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm dhe njësitë tjera organizative të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Në kuptim të nenit 38 pika (e) të Ligjit Nr.02/L – 59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin, Këshilli Drejtues i Operës së Kosovës, e zgjedhë drejtorin e Operës ndërsa përbërja prej pesë (5) anëtarëve e Këshillit Drejtues të Operës, sikurse përcaktohet me nenin 37 të Ligjit Nr.02/L – 59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin, kërkon një përfaqësim si në vijim: një (1) përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, një (1) përfaqësues nga shoqëria civile, një (1) përfaqësues nga fakulteti i arteve dhe dy (2) punëtorë të rregullt në marrëdhënie pune nga radhët e institucionit të Operës së Kosovës.

Institucioni i Operës së Kosovës është institucion i ri i porsa themeluar dhe si i tillë, aktualisht nuk ka punëtorë të rregullt në marrëdhënie pune që nënkupton se emërimi dhe konstituimi i Këshillit Drejtues të institucionit të Operës nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili më pas do të vijonte të procedurën e zgjedhjes së drejtorit, është i pamundur. Në këto kushte, duke u nisur nga fakti se Këshilli Drejtues është organ që emërohet dhe i përgjigjet Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit si organ epror i tij, duke zbatuar parimin e hierarkisë funksionale përkatësisht faktin se funksioni i ministrit në hierarki funksionale dhe administrative, është epror i Këshillit Drejtues, në bazë të parimit të proporcionalitetit dhe me qëllim të krijimit të kushteve ligjore për emërimin dhe funksionlizimin e organeve drejtuese të institucionit, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, subsidiarisht delegon përgjegjësitë e funksionit të Drejtorit të Institucionit të Operës, personit si në dispozitiv të këtij vendimi, në cilësinë e organit epror të Këshillit Drejtues – organit që sipas ligjit e zgjedhë këtë funksion.

Mbi bazën e arsyeve të shpjeguara më lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Palës së emëruar;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor/MKRS;
- Departamentit të Kulturës;
- Arkivit të MKRS-së;

